

Shoqata e kontabilistëve të çertifikuar dhe auditorëve të Kosovës

**Auditim
(Zgjidhjet)**

P6

Data 28/01/2023

Detyra 1

Sot është 1 korrik 2022. Kaltrina ShPK është prodhuese e pjesëve metalike të karrigeve. Viti fiskal përfundon me 30 shtator 2022. Ju jeni senior i auditimit në firmën D-Kont dhe jeni duke rishikuar ekstraktet e dokumentimit të kontrolleve të brendshme të Kaltrina ShPK si përgatitje për auditim.

Shitjet

Të gjithë konsumatorët e rinj të Kaltrina kërkohet t'i nënshtrohen kontrollit kreditor (aftësisë së pagesës). Pasi që të kalojnë këtë kontroll, konsumatorët regjistrohen në dosjen kryesore të llogarive të arkëtueshme dhe caktohet limiti kreditor nga drejtori i shitjes. Limitet kreditore ndryshohen vetëm nëse kërkohet rritje e limitit nga konsumatori.

Porositë e konsumatorëve procesohen nga departamenti i porosive të shitjeve të kompanisë dhe mallrat dërgohen nga njëra nga depot e kompanisë. Më pas plotësohen fletë-dërgesat shumëpjesëshe dhe njëra kopje mbetet në depo pasi që mallrat dërgohen. Kopjet tjera të fletë-dërgesës dërgohen në departamentin e porosive të shitjeve dhe në departamentin e financave në baza javore.

Kontrolluesja e kredisë në kompaninë Kaltrina aktualisht është në pushim të lehonisë për gjashtë muaj dhe askush nuk është duke e zëvendësuar. Si pjesë e procedurave të fundit të muajit, një zyrtar harmonizon llogarinë kontrolluese të llogarive të arkëtueshme me librin e llogarive të arkëtueshme dhe këto harmonizime rishikohen nga kontabilisti vetëm nëse ka ndonjë diferencë të paharmonizuar.

Pasuritë joqarkulluese

Kompania përcakton një buxhet vjetor për shpenzimet kapitale për secilin departament të kompanisë dhe është pjesë e procesit të aprovimit. Aprovimi i bordit kërkohet për çdo artikull kapital që kushtojnë më shumë se 500,000 Euro. Shpenzimet kapitale nën këtë nivel mund të autorizohen nga kryesuesi i departamentit përkatës.

Kaltrina ShPK ka një zyre kryesore dhe pesë fabrika, secila nga ato ka depon e saj. Kompania ka departamentin e auditimit të brendshëm nga i cili kërkohet që në cikël prej tre vjetësh të kryej krahasimin në mes të të gjitha pasurive të regjistruara në regjistrin e pasurive joqarkulluese me pasuritë fizike në të gjitha 11 lokacionet e kompanisë. Sipas programit të auditimit të brendshëm për vitin aktual, kjo do të thotë se ata do të kenë përfunduar këtë krahasim në vetëm një fabrikë dhe një depo.

Blerjet dhe stoqet

Kaltrina mban një sistem të vazhdueshëm të shtoqueve në të cilin produktet e gatshme dhe lënda e parë, që mbahen në depo, numërohen çdo muaj përgjatë tërë vitit në vend që të numërohen në fund të vitit. Secili nga menaxherët e depove është përgjegjës për mbikëqyrjen e numërimit të stoqeve në depon e tyre dhe për tu siguruar se ekipet e numërimit janë duke i ndjekur udhëzimet për numërim.

Kompania e llogarit koston e stoqeve duke përdorur koston standarde, edhe për raportim menaxherial po ashtu edhe për përfshirje në pasqyra financiare në fund të vitit. Baza e koston standarde ishte rishikuar nga departamenti i prodhimit para dy vitesh.

Kompania ka një departament qendror të blerjes që gjendet në zyrat qendrore. Të gjithë të punësuarit e departamentit kanë qasje në listën kryesore të furnitorëve. Një raport mujor për ndryshimet në këtë listë gjenerohet automatikisht dhe arkivohet nga një nëpunës i blerjeve.

Fletë-pranimet me numra të njëpasnjëshëm gjenerohen nga departamenti i depos kur mallrat pranohen, një kopje e së cilës dërgohet menjëherë në departamentet e blerjes dhe të financave. Me pranimin e faturës së blerjes, nëpunësi në financa e përputh faturën me urdhërblerjen dhe e përcjell dokumentin te drejtori financiar për autorizim para regjistrimit në kontabilitet.

Kërkohe:

Në mënyrë që të përftohet dëshmi e mjaftueshme dhe e përshtatshme e auditimit, auditori nuk mund të mbështetet plotësisht në sistemin e kontrollit të brendshëm të entitetit. Përveç kryerjes së testeve të kontrollit, auditorët gjithmonë duhet të kryejnë disa teste thelbësore për shkak të kufizimeve në kontrolle të brendshme.

a) Përshkruani KUFIZIMET në kontrollin e brendshëm

Shënim: referojuni skenarit të mësipërm për t'u përgjigjur në këtë kërkesë. (4 pikë)

b) Identifikoni dhe shpjegoni TETË mangësi në sistemin e kontrollit të brendshëm dhe ofroni rekomandimet për të adresuar mangësitë e identifikuar. (16 pikë)

(Total: 20 pikë)

Zgjidhja

Kufizimet e kontrollit të brendshëm

Ekzistojnë kufizime në çdo sistem të kontrollit të brendshëm që ndikon në masën në të cilën auditori mund të mbështetet në të. Kufizimet janë si më poshtë:

Gabim njerëzor në hartimin ose zbatimin e një kontrolli të brendshëm

Një entitet mund të ketë një proces adekuat të kontrollit të brendshëm mbi një fushë të caktuar të pasqyrave financiare. Megjithatë, gabimi njerëzor në zbatimin e këtij kontrolli shkakton një kufizim të vetvetishëm, për shembull një punonjës mund të rishikoj një rakordim bankar, por të mos identifikojë një gabim. Mund të ketë gjithashtu një të metë në hartimin e kontrollit të brendshëm, ku ka një gabim në hartimin ose ndryshimin e një kontrolli të brendshëm që do të thotë se ai nuk funksionon siç synohet.

Anashkalimi i kontrollit të brendshëm

Asnjë sistem i kontrollit të brendshëm nuk do të jetë plotësisht efektiv në parandalimin dhe zbulimin e mashtrimit dhe gabimit. Punonjësit mund të manipulojnë mangësitë në kontrollin e brendshëm të një entiteti për përfitime personale ose për të fshehur aktivitetin mashtrues. Kjo ka më shumë gjasa të jetë e mundur kur ka marrëveshje të fshehtë midis punonjësve.

Anashkalimi i kontrollit të brendshëm nga menaxhmenti

Menaxhmenti është në pozitë për të anashkaluar kontrollin e brendshëm të një entiteti, pavarësisht nga fuqia e sistemit të kontrollit të brendshëm. Një anashkalim i tillë i menaxhmentit mund të bëhet për të fshehur informacionin ose për përfitime personale financiare.

Përdorimi i gjykimit mbi natyrën dhe shtrirjen e kontrolleve

Menaxhmenti është përgjegjës për zbatimin e kontrolleve që janë krijuar për të parandaluar, zbuluar dhe korrigjuar anomalitë materiale dhe për të ruajtur pasuritë e kompanisë. Do të nevojitet një gjykim profesional për të përcaktuar llojin dhe shtrirjen e kontrolleve të brendshme të nevojshme brenda kompanisë dhe disa kontrolle mund të mungojnë ose të jenë joefektive. Në veçanti, sistemet mund të dizajnohen për t'u marrë me transaksionet rutinë dhe për këtë arsye mund të jenë të papërshtatshme në lidhje me transaksionet jo rutinë.

b) Mangësitë në kontrolle dhe rekomandimet

Mangësitë në kontrolle	Rekomandim kontrolli
Kufijtë e kreditor të vendosura nga drejtori i shitjeve ndryshohen vetëm kur një klient kërkon një rritje. Nëse kufijtë nuk rishikohen rregullisht, ato mund të jenë të vjetruara, duke rezultuar me shitje me afat pagese për klient të cilët e kanë humbur aftësinë e pagesës që mund të shkaktojnë rritje të LLA ose, përndryshe, kufijë shumë të ulët dhe për rrjedhojë kompania mund të humb të hyra të mundshme	Kufijtë e kredisë duhet të vazhdojnë të vendosen nga drejtori i shitjeve, megjithatë këto kufij duhet të rishikohen dhe ndryshohen sipas rastit në baza të rregullta nga një zyrtar përgjegjës, për shembull, drejtori financiar ose drejtori i shitjeve.
Fletëdërgesat (FD) dërgohen në departamentin e financave në baza javore. Nëse departamenti i financave nuk merr menjëherë FD, kjo mund të rezultojë në dërgimin e mallrave, por faturim me vonesë. Kjo mund të rezultojë me probleme të prerjes së të hyrave dhe të arkëtueshme të nënvlerësuar.	Kopjet e FD-ve duhet t'i dërgohen departamentit të financave më shpesh, si për shembull çdo ditë. Departamenti i financave duhet të ndërmarrë një kontroll të numrave të njëpasnjëshëm të FD-ve për të siguruar që asnjë nuk mungon për përpunim.
Kontrolluesja e kreditit të kompanisë aktualisht është në pushim lehonie për gjashtë muaj dhe askush nuk e ka marrë përsipër detyrën e saj. Prandaj, gjatë kësaj periudhe askush nuk ka qenë përgjegjës për monitorimin dhe ndjekjen e të arkëtueshmeve të vjetra. Kjo mund të rezultojë në një rrezik të shtuar të të arkëtueshmeve të parikuperueshme dhe të çojë në mospagimin e saldove të papaguara në kohë nga klientët, ose mund të çojë në zvogëlimin e rrjedhës monetare.	Gjatë periudhës së pushimit të lehonisë, një personel alternativ i departamentit të financave duhet të trajnohet në rolin e kontrollit të kredisë (ose të rekrutohet një kontrollues i përkohshëm i kredisë) dhe të caktohet përgjegjësia për rishikimin e listimit të të arkëtueshmeve të vjetra dhe ndjekjen e çdo klienti që është vonuar me pagesë.
Barazimi mujor i llogarisë së kontrollit të librit të të arkëtueshmeve rishikohet nga kontabilisti vetëm nëse ka ndonjë diferencë të pabarazuar. Barazimi i llogarisë së kontrollit mund të rakordojë, por ende përmban gabime të rëndësishme pasi mund të ketë gabime kompensuese të cilat anulojnë njëra-tjetrën ose	Barazimet duhet të rishikohen nga kontabilisti në baza mujore, edhe nëse nuk ka përjashtime, dhe rishikimi duhet të evidentohet me nënshkrimin e barazimit.

<p>mund të jetë përgatitur ose manipuluar gabimisht dhe kjo nuk do të identifikohet. Nëse rakordimi nuk rishikohet, atëherë kjo zvogëlon ndjeshëm efektivitetin e tij.</p>	
<p>Zërat e shpenzimeve kapitale nën 0.5 milion Euro autorizohen nga drejtori përkatës i departamentit. 0.5 milion Euro është një shumë e konsiderueshme dhe megjithëse krerët e departamenteve marrin përsipër procesin e autorizimit , ka ende hapësirë të konsiderueshme për përdorim jo-biznesi ose pasuri të tepërta që blihen duke çuar në ulje të fitimeve dhe rrjedhë të parave për kompaninë.</p>	<p>Niveli i autorizimit për drejtorët e departamenteve duhet të reduktohet ndjeshëm në një nivel më të përshtatshëm, si p.sh. 25,000 Euro. Çdo shumë që tejkalon këtë duhet të miratohet nga bordi. Nëse kjo rezulton shumë e vështirë, duhet të krijohet një komitet i shpenzimeve kapitale të udhëheqësve të lartë për autorizimin e zërave kapitalë. Ky komitet duhet t'i raportojë bordit.</p>
<p>Departamenti i auditimit të brendshëm (AB) ndërmerr verifikimin fizik të pasurisë çdo vit. Është supozuar të verifikojë të gjitha pasuritë në një cikël tre vjeçar, por në vitin aktual AB do të kryejë procedurat përkatëse vetëm në një fabrikë dhe një depo. Kompania ka pesë fabrika dhe depo dhe një zyrë qendrore. Prandaj, mbi këtë bazë do të duhen mbi pesë vjet për të verifikuar fizikisht të 11 vendet. Nëse regjistri i pasurive joqarkulluese nuk verifikohet fizikisht në baza të rregullta, ekziston një rrezik në rritje që pasuritë të shpërdorohen ose pasuritë e vjetruara të përfshihen ende në regjister, pasi nuk ka kontroll që pasuritë ende ekzistojnë në gjendje të mirë pune.</p>	<p>AB duhet të rishikojë programin e saj të vizitave për të vlerësuar nëse burime shtesë mund të dedikohen për të siguruar që të 11 vendet të vizitohen në përputhje me politikën e tre viteve. Kjo do të siguronte që verifikimi fizik i të gjitha pasurive të mund të kryhej më rregullisht. Gjatë vizitave çdo pasuri që nuk mund të gjendet duhet të hetohet plotësisht për të identifikuar se ku mund të jenë. Nëse ato nuk mund të gjenden, atëherë ato duhet të hiqen nga listat dhe kontabiliteti.</p>
<p>Menaxheri i depos në secilën nga pesë lokacionet e kompanisë është përgjegjës për mbikëqyrjen e numërimit të vazhdueshëm mujor të stoqeve dhe për t'u siguruar që ekipet e numërimit po ndjekin udhëzimet e tyre. Menaxherët e depos mund të dëshirojnë të fshehin joefikasitetin dhe mospërputhjet e stoqeve në mënyrë që departamentet e tyre të mos kritikohen . Kjo mund të rezultojë që të dhënat e numërimit të stoqeve të jenë të pasakta, si dhe rritje të rrezikut të mashtrimit në stoqe.</p>	<p>Numërimi i stoqeve duhet të mbikëqyret nga një person i pavarur, si p.sh. një anëtar i departamentit të AB të kompanisë.</p>
<p>Kompania vlerëson stoqet e saj duke përdorur kostot standarde, të cilat nuk mbahen të përditësuara. Nëse kostot standarde janë rishikuar për herë të fundit dy vjet më parë, ekziston rreziku që kostot të kenë anomali pasi ndryshimet në lëndët e para dhe kostot e pagave mund të mos jenë përshtatur. Kjo mund të rezultojë në keqdeklarim të stoqeve dhe fitimeve. Për më tepër, për raportimin në fund të vitit, SNK 2 Stoqet lejon që kostot standarde të</p>	<p>Një rishikim i të gjitha kostove standarde aktualisht në përdorim duhet të ndërmerret nga një menaxher i lartë në departamentin e prodhimit. Kostot aktuale për materialet, punën dhe shpenzimet e përgjithshme duhet të konstatohen dhe të krahasohen me kostot standarde të propozuara për të siguruar që ato janë një përafrim i afërt. Kostot standarde të rishikuara duhet të rishikohen nga drejtori i prodhimit i cili duhet të evidentojë këtë</p>

<p>përdoren për qëllime vlerësimi, nëse ato janë një përfaqsim i afërt me kostot aktuale, gjë që nuk ka gjasa nëse kostot standarde mbeten të pandryshuara për një periudhë të gjatë kohore. Prandaj, kostoja e stoqeve mund të mos jetë në përputhje me SNK 2.</p>	<p>rishikim. Të paktën çdo vit, një rishikim i kostove standarde duhet të ndërmerret nga drejtori i prodhimit për të siguruar që ato janë të përditësuara.</p>
<p>Qasja në të dhënat e dosjes kryesore për furnitorët është e disponueshme për të gjithë ata në departamentin e blerjeve dhe raporti mujor i ndryshimeve në të dhënat e dosjes kryesore nuk rishikohet. Të gjithë anëtarët e departamentit të blerjeve mund të ndryshojnë të dhënat dhe, potencialisht, të shtojnë furnitorë të rinj në sistemin e librit të llogarive të pagueshme, dhe meqenëse raporti i ndryshimeve nuk është rishikuar, nuk ka gjasa që kjo të identifikohet. Kjo çon në një rritje të rrezikut të mashtrimit pasi nëpunësit mund të shtojnë furnitor fiktiv dhe më pas të bëjnë porosi mashtruese pa u zbuluar.</p>	<p>Raporti mujor i ndryshimeve në të dhënat e dosjes kryesore duhet të rishikohet nga një zyrtar përgjegjës, i cili duhet të evidentojë këtë rishikim. Çdo ndryshim i paautorizuar ose i papritur duhet të hetohet dhe të ndërmerren veprimet e duhura. Aftësia për të bërë ndryshime në të dhënat e dosjes kryesore duhet të kufizohet në ato të kërkuara dhe të autorizuara për të bërë ndryshime në këto të dhëna.</p>
<p>Faturat e blerjes nuk rakordohen me shënimet përkatëse nga fletëpranimet e mallrave (FP) përpara autorizimit dhe regjistrimit në sistem. Kjo mund të rezultojë në pagimin e faturave për mallrat që nuk janë pranuar, duke rezultuar në rritjen e kostove.</p>	<p>Të gjitha faturat e blerjes duhet të përputhen si me porosinë e blerjes ashtu edhe me FP-në përkatëse. Detajet duhet të përputhen përpara se fatura të autorizohet dhe të regjistrohet në librin e llogarive të pagueshme .</p>

Detyra 2

Është 1 korrik 2022. Drini ShA është kompani e listuar në bursë dhe shet mallra të ndryshme me shumicë. Kompania ka një zyrë të madhe qendrore dhe 18 depo. Ju jeni menaxher i auditimit në firmën Motrat-Audit dhe jeni duke u përgatitur për fillimin e auditimit për vitin që përfundoi me 31 mars 2022. Pasqyrat financiare draft paraqesin pasuri totale prej 198.5 milion Euro dhe fitim para tatimit prej 56.1 milion Euro. Më poshtë janë paraqitur tri çështje që duhet të konsiderohen:

Toka dhe ndërtesat

Drini historikisht i regjistron pasuritë joqarkulluese me kosto minus zhvlerësimi i akumuluar. Mirëpo gjatë vitit, menaxhmenti ka vendosur të ndryshojë politikën e kontabilitetit për tokën dhe ndërtesat nga modeli i koston në modelin e rivlerësimit. Kompania ka angazhuar një vlerësues të jashtëm të pavarur për të bërë rivlerësimin e tokës dhe ndërtesave dhe kjo ka ndodhur në korrik të vitit 2021. Zhvlerësimi llogaritet në bazë mujore. Saldo përfundimtare e tokës dhe ndërtesave në fund të vitit ishte 79.2 milion Euro (2021: 64 mil).

Konfirmimi i llogarive të arkëtueshme

Saldo përfundimtare e vitit e llogarive të arkëtueshme prej 9.3m Euro (2021: 7.7m) ishte rritur në mënyrë domethënëse krahasuar me vitin e kaluar. Saldo e këtyre llogarive përbëhet nga një numër i madh i konsumatorëve me saldo prej 15,000 Euro deri në 150,000 Euro. Auditorët kanë vendosur të përdorin konfirmime pozitive bazuar në saldod përfundimtare të vitit. Shumica e përgjigjeve nga konsumatorët është përputhur me saldod e paraqitura në konfirmim, përveç përjashtimeve të mëposhtme:

Konsumatori	Saldo sipas Drini ShA	Përgjigja nga konsumatori
Ujmiri ShA	€141,102	Nuk janë përgjigjur
Nerodimja ShA	€136,321	€122,189

Provizioni dhe të arkëtueshmet nga shitja e mallrave me defekte

Në nëtor 2021, Drini ShA ka shitur fshesa të mençura shtëpiake te konsumatori Koni ShPK. Nga kompani Koni është pretenduar se artikujt ishin me defekt dhe ka pasur raste kur këto i ka kapluar zjarri. Si rezultat i këtyre ngjarjeve, Koni ka paditur kompaninë Drini për 3.9 milion Euro. Seanca gjyqësore është caktuar për gusht 2022 dhe menaxhmenti beson se pretendimet e Koni ka gjasë të jenë të suksesshme. Nuk kishte asnjë fshesë të mbetur në stoqet e fundvitit.

Drini i blen fshesat elektrike nga furnitori Automatika ShA. Në shkurt të vitit 2022, Drini ka kontaktuar kompaninë Automatika dhe ka kërkuar të rimbursojnë Drini ShA për dëmet e shkaktuara që mund të jenë të pagueshme si rezultat i produkteve me defekt. Drini është duke kërkuar 3.9 milion Euro nga Automatika. Pasqyrat financiare draft të Drini përmbajnë një provision prej 3.9 mil Euro në lidhje me pretendimin nga konsumatori dhe një të arkëtueshme prej 3.9 mil Euro si pretendim ndaj furnitorit.

Kërkohet:

- a) Përshkruani procedurat thelbësore që duhet të kryhen nga auditori për të përfutur dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit lidhur me tokën dhe ndërtesat e Drini ShA. (6 pikë)
- b) Përshkruani përocedurat që duhet të kryhen lidhur me përjashtimet që janë vërejtur nga përgjigjet ndaj konfirmimeve të arkëtueshme të Ujmiri dhe Nerodimja. (4 pikë)
- c) Përshkruani procedurat thelbësore që duhet të kryhen nga auditori për të përfutur dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit lidhur me PROVIZIONIN dhe TË ARKËTUESHMEN që lidhen me shitjen e mallrave me defekt. (5 pikë)

Partneri i angazhimit të auditimit ka përcaktuar se çështja lidhur me provizionin dhe të arkëtueshmet për shitjen e mallrave me defekt duhet të komunikohet si Çështje Kyçe e Auditimit (ÇKA), në pajtueshmëri me SNA 701 Komunikimi i Çështjeve Kyçe të Auditimit në Raportin e Auditorit të Pavarur.

- d) (i) Përshkruani faktorët që do të kishte konsideruar auditori në përcaktimin se një çështje është ÇKA; dhe
(ii) Përshkruani përmbajtjen e një seksioni ÇKA të raportit të auditorit për Drini ShA. (5 pikë)

(Total: 20 pikë)

Zgjidhja

Drini ShA

(a) Toka dhe ndërtesa

- Merrni një listë të të gjithë tokës dhe ndërtesave, mbledhni totalët dhe përputhni me bilancin vërtetues dhe pasqyrat financiare.
- Merrni parasysh kompetencën dhe aftësinë e vlerësuesit, duke vlerësuar përmes intervistave, kualifikimin e tyre, anëtarësimin në një organizatë profesionale dhe përvojën në vlerësimin e këtyre llojeve të pasurive.
- Rishikoni supozimet dhe metodën e përdorur nga vlerësuesi në ndërmarrjen e rivlerësimit për të konfirmuar arsyeshmërinë dhe përputhshmërinë me parimet e SNK 16.
- Përputhni listën e tokës dhe ndërtesave të rivlerësuara me deklaratën e vlerësimit të dhënë nga vlerësuesi dhe me regjistrin e pasurive joqarkulluese.
- Përputhni gjitha tokat dhe ndërtesat në regjistrin e pasurive joqarkulluese me raportin e vlerësimit për të siguruar plotësinë e tokës dhe ndërtesave të vlerësuara për të siguruar që të gjitha pasuritë në të njëjtën kategori janë rivlerësuar në përputhje me SNK 16.
- Rillogaritni rregullimin total të rivlerësimit dhe rakordoni saldon e regjistruar të rivlerësimit.
- Rillogaritni shpenzimin e zhvlerësimit për vitin dhe konfirmoni se për pasuritë e rivlerësuara në korrik 2022, zhvlerësimi është bazuar në koston para rivlerësimit dhe në bazë të vlerësimit më pas në bazë proporcionale.
- Për një mostër të tokave dhe ndërtesave nga regjistri i pasurive joqarkulluese, verifikoni fizikisht për të konfirmuar ekzistencën.
- Për një mostër të tokave dhe ndërtesave, gjurmoni në regjistrin e pasurive joqarkulluese dhe librin kryesor për të konfirmuar plotësinë.

- Rishikoni shpalosjet e pasqyrave financiare në lidhje me tokën dhe ndërtesat për t'u siguruar që ato janë në përputhje me SNK 16.

(b) Përjashtimet në konfirmimin e të arkëtueshmeve tregtare

Ujmiri ShA

- Për mospërgjigjen nga Ujmiri, me lejen e klientit, ekipi duhet të organizojë dërgimin e një kërkesë tjetër për konfirmim.
- Nëse Ujmiri nuk i përgjigjet kërkesës së re atëherë me lejen e klientit, auditori duhet t'i telefonojë klientit dhe të pyesë nëse ai është në gjendje t'i përgjigjet me shkrim kërkesës për konfirmim.
- Nëse ende nuk ka përgjigje, atëherë auditori duhet të ndërmarrë procedura alternative për të konfirmuar saldon e papaguar nga Ujmiri. Këto do të përfshijnë testimin e detajuar të saldosit duke rishikuar inkasimet pas datës dhe duke dakorduar me faturat e shitjes dhe fletë-dërgesat (FD).

Nerodimja ShA

- Për përgjigjen nga Nerodimja, auditori duhet të hetojë diferencën prej 14,132 Euro dhe të identifikojë nëse kjo lidhet me diferencat kohore ose nëse ka gabime të mundshme në të dhënat e Drini.
- Nëse diferenca është për shkak të kohës, të tilla si paratë e gatshme në tranzit, detajet e diferencës duhet të rakordohen me arkëtimet e parave në fund të vitit në librin e parave.
- Nëse diferenca ka të bëjë me mallrat në tranzit, atëherë detajet duhet të dakordohen me një fletë-dërgesë para fundit të vitit .
- Libri i llogarive të arkëtueshme duhet të rishikohet për të identifikuar çdo postim të gabuar të mundshëm pasi kjo mund të jetë një arsye për ndryshimin me Nerodimja.

(c) Provizionet dhe të arkëtueshmet që lindin nga shitja e mallrave me defekt

- Rishikoni korrespondencën me Koni dhe përcaktoni detajet e pretendimit për të vlerësuar nëse një detyrim aktual si rezultat i një ngjarjeje të kaluar ka ndodhur.
- Rishikoni korrespondencën me Automatika, furnizuesin e fshesave, për të vlerësuar nëse ata pranojnë përgjegjësi për defektin.
- Rishikoni korrespondencën me këshilltarët ligjorë të Drini ose, me lejen e klientit, kontaktoni këshilltarët ligjorë për të marrë mendimin e tyre në lidhje me probabilitetin që pretendimi ligjor nga klienti dhe kërkesa për rimbursim nga furnizuesi të jenë të suksesshme, si dhe çdo shumë të mundshme që duhen paguar ose marrë.
- Diskutoni me menaxhmentin/pyetni këshilltarin ligjor nëse ndonjë klient tjetër i Drini ka përjetuar probleme me shitjet e fshesave dhe rrjedhimisht gjasat e ndonjë pretendimi të mundshëm në të ardhmen.
- Rishikoni procesverbalet e bordit për të përcaktuar nëse drejtorët besojnë se pretendimi do të jetë i suksesshëm apo jo.
- Rishikoni librin e parave të gatshme pas fundit të vitit për të vlerësuar nëse është bërë ndonjë pagesë ndaj klientit ose janë pranuar para nga furnizuesi dhe krahasoni me shumat e njohura në pasqyrat financiare.
- Diskutoni me menaxhmentin pse ata kanë përfshirë një të arkëtueshme për pretendimin kundër furnitorit pasi ky është ndoshta një pasuri kontingjente dhe duhet të njihet si pasuri vetëm nëse marrja e parave është praktikisht e sigurt. Merrni parasysh arsyeshmërinë e trajtimit të propozuar.
- Merrni një përfaqësim me shkrim që konfirmon pikëpamjen e menaxhmentit se padia nga Koni ka gjasë të jetë e suksesshme dhe pretendimi kundër Automaika është praktikisht i sigurt dhe prandaj kërkohet të përfshihet një provizion dhe një llogari e arkëtueshme.
- Rishikoni përshatshmërinë e shpalosjeve të padisë dhe pretendimit të furnitorit në draft pasqyrat financiare për t'u siguruar që ato janë në përputhje me SNK 37.

(d) Çështjet kryesore të auditimit

(i) Faktorët që duhen marrë parasysh

Meqenëse Drini ShA është e listuar në bursë, një seksion i Çështjeve Kryesore të Auditimit (ÇKA) do të kërkohet në raportin e auditorit. Partneri i auditimit do të kishte marrë parasysh nëse çështja u ishte komunikuar atyre që janë të ngarkuar me qeverisjen pasi ÇKA janë përzgjedhur nga çështjet e komunikuar me personat e ngarkuar me qeverisjen. Partneri i auditimit do të kishte marrë në konsideratë gjithashtu nëse çështja në lidhje me pretendimet ishte një fushë me rrezik më të lartë të vlerësuar të anomalive materiale ose një rrezik i rëndësishëm dhe pasi është një vlerësim kontabël, niveli i gjykimit të përfshirë në këtë çështje. Partneri i auditimit do të ketë marrë gjithashtu në konsideratë nëse, sipas gjykimit të tij profesional, çështjet në lidhje me pretendimin dhe kundërpadinë ishin të rëndësishme më të madhe në auditimin e pasqyrave financiare të Drini për vitin e mbyllur më 31 mars 2022, prandaj kërkon vëmendje të konsiderueshme të auditorit.

(ii) Përmbajtja e seksionit ÇKA

Seksioni ÇKA i raportit të auditorit duhet të ofrojë një përshkrim të çështjes. Duhet të detajojë se pse kjo çështje është konsideruar si një fushë me rëndësi më të madhe në auditim dhe për këtë arsye është përcaktuar si një ÇKA. Ai do të përfshijë një referencë për rrezikun e auditimit për plotësinë e provizionit dhe njohjes së të arkëtueshmeve dhe nivelin e gjykimit të kërkuar për të bërë këtë vlerësim. Ai gjithashtu duhet të shpjegojë se si është adresuar çështja në auditim dhe auditori duhet të ofrojë një përmbledhje të shkurtër të procedurave të auditimit të miratuara si dhe të bëjë një referencë shpalosjes përkatëse në pasqyrat financiare.

Detyra 3

Ju jeni senior i auditimit në firmën Vanda dhe jeni në proces të planifikimit të auditimit të kompanisë Shetech ShA, një kompani që shet telefona celular, pajisje zërimi dhe të ngjashme. Tani është 1 korrik 2022 dhe viti financiar i kompanisë përfundon me 31 gusht 2022. Të hyrat e parashikuara të kompanisë janë €12.2 milion, pasuritë totale €6.8 mil dhe fitimi para tatimit €2.8 mil. Menaxheri i auditimit ka mbajtur një takim me drejtorin financiar dhe ju ka ofruar shënimet nga takimi:

Shënimet nga takimi me drejtorin financiar

Kompania operon me 20 dyqane që janë të shpërndara në tërë vendin dhe iu shet produkte konsumatorëve individual dhe shitësve me pakicë. Kompania ka një politikë të kthimit të mallrave brenda 28 ditësh nga data e blerjes nëse ata nuk janë të kënaqur me produktin. Historikisht, 5% e konsumatorëve kthejnë mallrat e blera brenda kësaj periudhe. Kompania po ashtu ofron një garancion 6 mujor për produktet e saj sipas së cilës kërkohet që Shetech të riparoj çfardo defekti në pajisjet e blera. Është parashikuar që provizioni për garanci në pasqyrat financiare draft të jetë më i ulët se sa vitin e kaluar pasi që drejtorët janë të sigurt se produktet e shitura nga kompania janë të prodhuara me standardet më të larta.

Kompania është e bazuar në Evropë ndërsa furnitori kryesor është në Azi. Mallrat dërgohen në depon qendrore të kompanisë përmes detit dhe zakonisht janë në tranzit deri në një muaj. Shetech ka përgjegjësinë për mallrat në tranzit nga pika e dërgesës së furnitorit. Depo qendrore dhe të gjitha 20 degët do të numërojnë fizikisht stoqet me 31 gusht 2022 dhe pritet që vlera e stoqeve në pasqyrat financiare të jetë 950,000 Euro.

Përgjatë gjashtë mujave të fundit, drejtori financiar ka vërejtur se periudha e mbledhjes së llogarive të arkëtueshme tani është mesatarisht 55 ditë, për derisa caku i kompanisë ishte 42 ditë. Kontrolluesja e kredisë ka informuar drejtorin financiar se është e sigurt se të gjitha llogaritë e arkëtueshme do të mbledhen pasi që periudha e zgjatur e mbledhjes së LLA është bërë e zakonshme në këtë industri. Drejtori financiar beson se ka pak gjasë të ketë nevojë për rritjen e lejimeve të llogarive të arkëtueshme në fund të vitit krahasuar me vitin e kaluar.

Në qershor 2022 është zbuluar një mashtrim në departamentin e financave. Një mbikëqyrës i llogarive të pagueshme i ka devijuar fondet nga llogaria e kompanisë duke përdorur një furnitor fiktiv në librin e llogarive të pagueshme. I punësuar është larguar menjëherë nga puna dhe vlera e mashtrimit është njohur si një shpenzim në pasqyrën e të ardhurave. Që nga largimi i mbikëqyrësit, nuk është regjistruar asnjë faturë e blerjeve në libra dhe ka pak gjasë që këto fatura të grumbulluara të paregjistruara do të arrijnë të regjistrohen deri në fund të vitit.

Gjatë vitit, kompania ka blerë dhe ka instaluar një sistem të automatizuar për dërgesa të mallrave në depon kryesore. Kosto e sistemit të dërgesave ishte 900,000 Euro dhe është njohur në pasqyrat financiare si pasuri joqarkulluese. Kosto e kapitalizimit përfshin çmimin blerës prej 600,000 Euro, koston e instalimit prej 200,000 Euro dhe koston e trajnimit të personelit prej 100,000 Euro.

Për shkak të kostove të ndodhura për sistemin e ri të dërgesave dhe të rritjes së periudhës së mbledhjes së llogarive të arkëtueshme, kompania ka rritur mbitërheqjen bankare në mënyrë domethënëse dhe në një moment kishte tejkalluar limitin e autorizuar prej 700,000 Euro në fillim të qershorit 2022. Banka kishte shprehur shqetësimet e saj për mënyrën se si kompania është duke operuar me mbitërheqjen

bankare dhe do të merret një vendim në nëntor 2022 nëse banka do të vazhdoj të ofroj mbitërheqje bankare për kompaninë. Raporti i auditorit pritet të nënshkruhet në tetor 2022.

Kërkohe:

SNA 210 Rënia dakord me kushtet e angazhimit të auditimit thekson se auditori duhet të pranoj ose të vazhdoj angazhimin e auditimit vetëm nëse ekzistojnë disa parakushte.

- a) Përshkruani PARAKUSHTET e kërkuara për një auditim. (3 pikë)
- b) Përshkruani SHTATË rreziqe të auditimit dhe përgjigjet e auditorit për secilin rrezik në planifikimin e auditimit të Shetech SHA. (14 pikë)
- c) Përkufizoni termin 'skepticismi profesional' dhe shpjegoni shembuj nga auditimi i Shetech SHA ku auditori duhet të zbatoj skepticismin profesional (3 pikë)

(Total: 20 pikë)

Zgjidhja

Shetec ShA

(a) Parakushtet e nevojshme për një auditim

Audituesit duhet të pranojnë një angazhim të ri auditimi ose të vazhdojnë një angazhim ekzistues auditimi nëse ekzistojnë parakushtet për një auditim. SNA 210 Dakordimi i Kushteve të Angazhimeve të Auditimit kërkon që auditori të:

- Përcaktoj nëse korniza e raportimit financiar që do të zbatohet në përgatitjen e pasqyrave financiare është e pranueshme (për shembull SNRF). Duke marrë në konsideratë këtë, audituesi duhet të kishte vlerësuar natyrën e entitetit, natyrën dhe qëllimin e pasqyrave financiare dhe nëse ligji ose rregullorja përshkruan kornizën e zbatueshme të raportimit.

- Përfton dakordimin e menaxhmentit që ai njih dhe kupton përgjegjësitë e tij për sa vijon:

- Përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kornizën e aplikueshme të raportimit financiar;
- Kontrolli i brendshëm i nevojshëm që përgatitja e pasqyrave financiare të jetë pa anomali materiale qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit; dhe
- Sigurimin e auditorit me qasje në informacionin e rëndësishëm për auditimin dhe qasje te personeli brenda entitetit për të përfutur evidencë auditimi.

(b) Rreziqet e auditimit dhe përgjigjet e auditorit

Rreziku i auditimit	Përgjigja e auditorit
Kompania ka një politikë kthimi që lejon një klient të kthejë mallrat brenda 28 ditëve nga blerja nëse ata janë të pakënaqur me produktin. SNRF® 15 Të ardhurat nga kontratat me klientët	Pyetni me drejtorin financiar se si është zbatuar politika e kthimit në fund të vitit dhe nëse janë pasqyruar dispozitat në SNRF 15.

<p>kërkojnë që të ardhurat të njihen vetëm në masën që mallrat nuk do të kthehen. Kompania duhet të njohë një detyrim rimbursimi për mallrat që pritet të kthehen.</p> <p>Nëse kompania nuk e ka llogaritur saktë detyrimin e rimbursimit, të ardhurat do të mbivlerësohen dhe detyrimi i rimbursimit do të nënvlerësohet.</p>	<p>Rishikoni supozimet që mbështesin detyrimin e rimbursimit për arsyeshmërinë dhe nëse ato përmbushin vlerën historike 5% të kthimeve.</p> <p>Krahasoni nivelin e kthimeve pas fundit të vitit me detyrimin e rimbursimit dhe diskutoni çdo ndryshim të rëndësishëm me menaxhmentin.</p>
<p>Kompania ofron një garanci gjashtëmujore për produktet e saj të cilat kërkojnë riparimin e defekteve me koston e vetë kompanisë. Drejtorët e kanë zvogëluar këtë provizion gjatë vitit me arsyetimin se ata mendojnë se produktet që ata shesin janë ndërtuar në një standard të lartë.</p> <p>Kompania nuk i prodhon mallrat (ato vetëm i shesin) prandaj nuk është një arsye e arsyeshme për zvogëlim të provizionit, prandaj nëse kompania ka reduktuar shumë provizionin e garancisë në fund të vitit, detyrimet dhe shpenzimet mund të nënvlerësohen.</p>	<p>Rishikoni llogaritjen e provizionit të garancisë dhe vlerësoni arsyeshmërinë e saj duke krahasuar me vlerën e pretendimeve të marra në periudhë.</p> <p>Rishikoni supozimet që mbështesin provizionin e garancisë për arsyeshmëri.</p> <p>Rishikoni nivelin e pretendimeve të bëra në kuadër të garancisë pas fundit të vitit për të vlerësuar arsyeshmërinë e provizionit të zvogëluar.</p>
<p>Kompania blen mallrat e tyre nga furnizuesi kryesor në Azi dhe ka përgjegjësi për mallrat në pikën e dërgimit, mallrat janë në tranzit deri në një muaj.</p> <p>Në fund të vitit, ekziston rreziku që prerja e blerjeve të mos jetë e saktë pasi ato mund të mos njohin saktë mallrat nga pika e dërgimit. Ekziston gjithashtu një rrezik që stoqet dhe të pagueshmet tregtare të nënvlerësohen në fund të vitit.</p>	<p>Diskutoni me menaxhmentin pikën në të cilën stoqet regjistrohet dhe rishikoni kontratën me furnizuesin për të verifikuar kërkesat.</p> <p>Rishikoni kontrollet që kompania ka për të siguruar që stoqet janë regjistruar nga pika e dërgimit.</p> <p>Ekipi i auditimit duhet të ndërmarrë testime të detajuara të prerjes së blerjeve të mallrave në fund të vitit dhe mostra edokumentacionit të transportit menjëherë para dhe pas fundit të vitit në lidhje me mallrat nga furnizuesi i tij kryesor në Azi duhet të rritet për të siguruar që prerja është e plotë dhe e saktë.</p>
<p>Depo qendrore e kompanisë dhe të 20 degët do të kryejnë një numërim të stoqeve në datën e fundvitit, 31 gusht.</p> <p>Nuk ka gjasa që auditori të jetë në gjendje të marrë pjesë në të gjitha vendet, gjë që rrit rrezikun e moszbulimit. Mund të mos jetë e mundur të sigurohet evidenca e mjaftueshme dhe e përshtatshme e auditimit mbi kontrollet e numërimit të stoqeve dhe plotësinë dhe ekzistencën e stoqeve për ato vende që nuk janë vizituar.</p>	<p>Ekipi i auditimit duhet të vlerësojë se cilin nga numërimet e stoqeve do të marrë pjesë. Kjo duhet të përfshijë numërimin për depon qendrore dhe një mostër të degëve që kanë saldo materiale të stoqeve dhe ato që historikisht kanë pasur përjashtime të raportuara gjatë numërimit të stoqeve.</p> <p>Për ato depo që nuk janë vizituar, auditori do të duhet të rishikojë nivelin e përjashtimeve të vërejtura gjatë numërimit dhe të diskutojë çdo çështje që ka dalë gjatë numërimit me menaxhmentin.</p>
<p>Gjatë gjashtë muajve të fundit, periudha e mbledhjes së të arkëtueshmeve është rritur nga 42 ditë në 55 ditë dhe provizioni për të</p>	<p>Rishikoni dhe testoni kontrollet për mënyrën në të cilën drejtori financiar vlerëson rikuperimin e saldove të arkëtueshme dhe proceseve të tjera të</p>

<p>arkëtueshmet do të jetë në të njëjtin nivel me vitin paraprak.</p> <p>Disa të arkëtueshme mund të mos jenë të rikuperueshme dhe nëse një provizion shtesë për të arkëtueshme nuk përfshihet në pasqyrat financiare, të arkëtueshmet do të mbivlerësohen dhe provizioni për të arkëtueshmet do të nënvlerësohet.</p>	<p>kontrollit të kredisë për të siguruar që ato funksionojnë në mënyrë efektive.</p> <p>Kryerja e testimit të zgjeruar të arkëtimitëve të parave të gatshme pas fundit të vitit dhe një rishikim i librit të llogarive të arkëtueshme të vjetra në mënyrë që të vlerësohet vlerësimi dhe nevoja për një rritje të provizionit për të arkëtueshmet e parikuperueshme.</p> <p>Diskutoni me drejtorin financiar nëse do të kërkohet një provizion shtesë për të arkëtueshmet kundrejt saldove më të vjetra se kushtet e kredisë së kompanisë.</p>
<p>Mbikëqyrësi i librit të llogarive të pagueshme u shkarkua në qershor për shkak të një mashtrimi. Vlera e këtij mashtrimi është njohur si shpenzim në draftin e pasqyrës së të ardhurave.</p> <p>Nëse mashtrimet shtesë të kryera nga mbikëqyrësi i librit të llogarive të pagueshme nuk zbulohen, kjo mund të rezultojë në nënvlerësimin e shpenzimeve dhe mbivlerësimin e të pagueshmeve. Rreziku i kontrollit rritet gjithashtu nëse mashtrimi ka mbetur i pazbuluar për një periudhë kohore.</p>	<p>Diskutoni me drejtorin financiar detajet e mashtrimit të kryer nga mbikëqyrësi i librit të llogarive të pagueshme dhe cilat procedura janë miratuar deri më sot për të identifikuar çdo rregullim të mëtejshëm që nevojitet në pasqyrat financiare. Përveç kësaj, diskutoni me drejtorin financiar se çfarë kontrollesh shtesë janë vendosur për të parandaluar çdo mashtrim të ngjashëm.</p> <p>Ekipi i auditimit duhet të ndërmarrë procedura të tjera thelbësore mbi saldon e të pagueshmeve, veçanërisht furnizuesin fiktiv të vendosur në librin e të pagueshmeve për të siguruar që kjo është hequr.</p> <p>Përveç kësaj, ekipi duhet të ruajë skepticizmin profesional dhe të jetë vigjilent ndaj rrezikut të mashtrimit të mëtejshëm.</p>
<p>Që nga shkarkimi i mbikëqyrësit të librit të llogarive të pagueshme, faturat e blerjeve ende nuk janë regjistruar në librin e llogarive të pagueshme.</p> <p>Ekziston rreziku që bilanci i blerjeve dhe të pagueshmeve tregtare në fund të vitit të nënvlerësohet nëse këto fatura nuk regjistrohen në librin e llogarive të pagueshme përpara se të mbyllet viti.</p>	<p>Rishikoni dosjen e faturave të papërpunuara në fund të vitit për të identifikuar çdo faturë që lidhet me furnizimin e mallrave të parafundit të vitit dhe për t'u siguruar që ato janë përlllogaritur siç duhet në pasqyrat financiare të fundvitit dhe janë njohur si detyrim.</p> <p>Diskutoni me drejtorin financiar qasjen që duhet të adoptohet për të zgjidhur çështjen e faturave të blerjeve të papërpunuara.</p>
<p>Kompania bleu dhe instaloi një sistem të ri dërgesave. Kostot që janë kapitalizuar përfshijnë kostot e trajnimit të stafit (0.1 milion euro).</p> <p>Sipas SNK® 16 Pronat, impiantet dhe pajisjet, kostoja e një pasurie përfshin vetëm çmimin e blerjes dhe kostot që i atribuohen drejtpërdrejt. SNK 16 nuk lejon që kostot e trajnimit të personelit të kapitalizohen si pjesë e kostos së një pasurie joqarklluese, pasi këto kosto nuk lidhen drejtpërdrejt me koston e sjelljes së pasurisë në gjendjen e saj të punës.</p>	<p>Diskutoni trajtimin kontabël me drejtorin financiar dhe kërkoni që kostot e trajnimit të përfshihen në PA për të siguruar që trajtimi është në përputhje me SNK 16. Nëse rregullohet, rishikoni regjistrimin në ditar për saktësi</p>

Kostot e trajnimit duhet të ngarkohet në PA. Prandaj, pronat, objektet dhe pajisjet (PPE) dhe fitimet janë të mbivlerësuara.	
Kompania ka shkelur kushtet e kredisë së saj të mbitërheqjes dhe banka do të konfirmojë vendimin nëse do të vazhdojë apo jo të mbështesë biznesin në nëntor, që është pas nënshkrimit të raportit të auditorit. Kompania është e varur nga mbitërheqja. Nëse banka refuzon të vazhdojë të mbështesë kompaninë, mund të ketë dyshime në lidhje me aftësinë e kompanisë për të vazhduar si vijimësi. Pasiguritë mund të mos shpalosen në mënyrë adekuate në pasqyrat financiare.	Diskutoni me drejtorin e financave disponueshmërinë e financimit alternativ nëse banka nuk është e gatshme të vazhdojë të mbështesë kompaninë dhe rishikoni përshatshmërinë e çdo shpalosje të vijimësisë në pasqyrat financiare. Ekipi i auditimit duhet të ndër marrë teste të detajuara për hipotezën e vijimësisë, në veçanti, duke rishikuar ndikimin e një mosrinovimi të mbitërheqjes.

(c) Skepticizmi profesional dhe shembujt ku duhet aplikuar skepticizmi profesional

Skepticizmi profesional përkufizohet në SNA 200 Objektivat e Përgjithshme të Auditorit të Pavarur dhe Kryerja e një Auditimi në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit si një qëndrim që përfshin një mendje pyetëse, duke qenë vigjilent ndaj kushteve që mund të tregojnë anomali të mundshme për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe një vlerësim kritik të dëshmive të auditimit. Shembujt ku auditori duhet të aplikojë skepticizëm profesional për kompaninë janë si më poshtë:

Njohja e të hyrave

SNA 240 Përgjegjësitë e Auditorit në lidhje me Mashtrimin në një Auditim të Pasqyrave Financiare përmban një supozim të kundërshtueshëm se mashtrimi në lidhje me të hyrat është me rrezik të lartë dhe për rrjedhojë auditori duhet të zbatojë skepticizëm profesional ndaj politikave të kompanisë për njohjen e të hyrave, veçanërisht në lidhje me politikën e kthimeve të kompanisë e cila për shkak të gjykimit të përfshirë mund të përdoret si një mënyrë për të manipuluar të hyrat.

Provizioni i garancisë

Kontabilizimi i provizionit të garancisë do të përfshijë një element të vlerësimi të bazuar në përvojat e mëparshme të kostove të bëra nga kompania për riparimin e mallrave me defekt. Auditori duhet të mbajë skepticizëm profesional duke mbajtur parasysh se provizionet e garancisë mund të përfshijnë paragjykime të menaxhmentit për të mbivlerësuar ose nënvlerësuar qëllimisht provizionin. Menaxhmenti ka zvogëluar provizionin e garancisë në vit me arsyetimin se ata mendojnë se mallrat që shesin janë prodhuar me një standard të lartë. Duke qenë se kompania nuk është e përfshirë në prodhimin e mallrave që shesin, mund të jetë e paarsyeshme të zvogëlohet provizioni i garancisë mbi këtë bazë.

Mashtrimi

Duke qenë se është kryer një mashtrim gjatë vitit, auditori duhet të ruajë skepticizmin profesional duke njohur faktin se kontrollet e brendshme mund të jenë të dobëta, duke lejuar kështu manipulimin mangësive në kontrolle të brendshme nga punonjësit. Auditori duhet gjithashtu të marrë parasysh mundësinë që mashtrime të tjera mund të kenë ndodhur gjatë vitit nëpërmjet anashkalimit të kontrolleve të brendshme të entiteti nga menaxhmenti.

Mbitërheqja bankare

Kompania mbështetet në mbitërheqjen e saj bankare për shkak të niveleve të konsiderueshme të shpenzimeve që ka kryer gjatë vitit në sistemin e ri të dërgesave. Menaxhmenti mund të dëshirojë të mbivlerësojë qëllimisht fitimin dhe të nënvlerësojë detyrimet në mënyrë që banka të rinovojë mbitërheqjen.

Vlerësimi i të arkëtueshmeve

Periudha e mbledhjes së të arkëtueshmeve është rritur gjatë gjashtë muajve të fundit, por drejtori financiar nuk parasheh që të kërkohet një rritje e provizionit për të arkëtueshmet. Auditori duhet të aplikojë skepticizëm profesional në shqyrtimin nëse vlerësimi i menaxhmentit për mbledhjen e të arkëtueshmeve është i arsyeshëm, pasi çdo rritje në provizion do të zvogëlojë fitimet.

Detyra 4

ComApp SHA është kompani e teknologjisë informative (TI) që zhvillon softuer dhe aplikacione për telefona celular dhe klientët kryesor janë bankat dhe institucionet financiare. Kompania punëson 500 punonjës me shkathtësi të lartë në zhvillimin e produkteve të TI dhe është e vendosur në 3 lokacione. Në dy vitet e fundit, kompania është duke u ballafaquar me rënie të shitjeve, edhe pse ende profitabile, kriza ekonomike ka ndikuar në operacionet e kompanisë. Konkurrenca në sektorin e teknologjisë informative është rritur në vitet e fundit ku kompanitë konkurrencte ofrojnë çmime me zbritje domethënëse. Kompania është duke pasur vështirësi në zëvendësimin e personelit duke pasur parasysh ikjen e tyre në kompani tjera konkurrencte. ComApp në vitin e fundit kishte blerë dy kompani të vogla të TI prej €3 milion. Gjithashtu kompania është duke eksploruar tregun e ofrimit të shërbimeve për mësimin online për universitetet vendore. Kjo linjë e re e shërbimeve është ende në filllet e zhvillimit. Për të mundësuar këtë shërbim, kompania kishte blerë të drejtat e shfrytëzimit të platformës për mësimet online në vlerë prej €2 milion. Drejtorët e kompanisë besojnë se platforma e mësimin online do të jetë një produkt profitabil i kompanisë. Këto kosto ishin financuar nga një kredi bankare. Konkurrenca më e afërt e kompanisë tashmë ka një prezencë të dukshme në shërbimet e mësimin online në vitet e fundit.

Banka IB, klient i kompanisë ishte qortuar nga rregullatori qeveritar i mbrojtjes së të dhënave pas një incidenti të publikimit të të dhënave të klientëve të bankës që përdornin aplikacionin e zhvilluar nga ComApp. Banka kishte paditur ComApp dhe kërkon dëmshpërblim prej €1 milion për neglizhencë sepse produkti i tyre nuk përmbante elementet kryesore të sigurisë së të dhënave. Si rezultat i kësaj ngjarje, zhvilluesi kryesor i aplikacioneve ishte larguar nga puna.

Dy nga huadhënësit kryesor të kompanisë kanë filluar të shqetësohen lidhur me aftësinë e kompanisë për të pagur kreditë dhe janë duke konsideruar tërheqjen e kredive. Drejtorët e kompanisë besojnë se kompania ka një të ardhme të ndritshme afatgjatë bazuar në profitabilitetin dhe në shifrat shpresëdhënëse nga shitjet shërbimeve të mësimin online. Auditorët janë informuar se drejtorët e ComApp kanë arranzhuar një numër të takimeve me huadhënësit e tyre për të diskutuar mundësinë e ristrukturimit të kredive të tyre. Këto takime do të mbahen pasi që auditori të përfundoj raportin e auditimit.

Kërkohet:

- a) Përshkruani përgjegjësinë e auditorit lidhur me hipotezën e vijimësisë. (2 pikë)
- b) Vlerësoni çfardo treguesi të mundshëm që ComApp mund të ketë problem me hipotezën e vijimësisë dhe vlerësoni ndikimin e tyre të mundshëm në afësinë e kompanisë për të vijuar tregëtimin. (8 pikë)
- c) Rekomandoni procedurat e auditimit që auditori i ComApp duhet të kryej në vlerësimin nëse kompania është duke operuar sipas hipotezës së vijimësisë. (6 pikë)
- d) Përshkruani ndikimin në raportin e auditimit nëse auditorët besojnë se ekziston një pasiguri materiale lidhur me hipotezën e vijimësisë së ComApp. (4 pikë)

(Total: 20 Pikë)

Zgjidhja

(a)

Përgjegjësia e auditorit për vijimësinë

Përgjegjësia e auditorit është të përftojë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit lidhur me përshatshmërinë e hipotezës së vijimësisë të përdorur nga menaxhmenti gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare. Auditori duhet të vlerësojë vlerësimin e bërë nga menaxhmenti lidhur me aftësinë e kompanisë për të vijuar ekzistencën dhe nëse ka ndonjë pasiguri materiale që mund të hedh dyshim mbi aftësinë e kompanisë për të vijuar e cila do të duhej të shpalosej në pasqyra financiare. Nëse identifikohen kushte ose ngjarje të cilat hedhin dyshim mbi aftësinë e kompanisë për të vijuar operacionet, auditori duhet të përftojë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të përcaktuar nëse ekziston një pasiguri materiale përmes kryerjes së procedurave shtesë të auditimit përfshirë ato që janë specifikuar në SNA 570.

Treguesit e hipotezës së vijimësisë

Treguesi	Pse mund të ndikojë në hipotezën e vijimësisë
Kompania është duke u ballafaquar me rënie të shitjeve në dy vitet e fundit.	Rënia e shitjeve do të thotë se kompania mund të ketë vështirësi në gjenerimin e rrjedhës së parasë për të mbuluar kostot.
Konkurrenca është rritur, e karakterizuar me 'çmime të zbritura' në mënyrë domethënëse.	Konsumatorët mund të ikin tek konkurrenca për shkak të çmimeve me zbritje ose kompania mund të zbres vetë çmimet deri në atë masë sa të mos jetë në gjendje të gjeneroj fitim ose rrjedhë të parasë së mjaftueshme.
Ikja e personelit	Kompania mund të ballafaqohet me mungesë të personelit me shkathtësi të lartë dhe vështirësi në zëvendësimin e tyre. Kjo mund të shkaktoj vonesa në përfundimin e angazhimeve si dhe produkte që janë zhvilluar në standardin e kërkuar dhe si rezultat humbje të të hyrave nga klientët.
Kompania ka investuar në një platformë të re për mësimet online.	Ekziston rreziku se platforma e re 'dështon' dhe kështu konsumatorët mund të kenë problem në përdorimin e platformës. Investimi mund të dështoj në mbulimin e kostove e që mund të rritë presionin financiar në kompani. Gjithashtu kjo linjë e shërbimeve është e re për kompaninë dhe nuk ka të dhëna nëse do të rezultoj e suksesshme.
Investimet domethënëse janë financuar përmes kredive të reja nga banka.	Kosto të larta të financimit rrisin rrezikun që kompania të mos jetë në gjendje të gjenerojë para të mjaftueshme për të mbuluar koston e interesit. Ka rrezik se mund të shkelen kushtet e kredisë që mund të rezultojn me tërheqjen e kredisë në bankat.
Kompania është paditur nga një klient për neglizhencë dhe kërkohet dëmshpërblim.	Dëmshpërblimi I kërkuar nga klienti është domethënëse për kompaninë dhe mund të rëndoj gjendjen financiare dhe rrjedhën e parasë. Gjithashtu kjo çështje mund të rezultojë me publicitet negativ dhe mungesë të besimit nga

	konsumatorët. Kjo pastaj mund të ndikojë në rënie të shitjeve por gjithashtu edhe në gjoba tjera që mund të ndikojë në hipotezën e vijimësisë.
Zhvilluesi kryesor është larguar nga kompania.	Humbja e personelit kyç do të thotë se kompania mund të mos jetë në gjendje të zhvilloj produkte të kërkuara. Kjo mund të rezultojë në rënie të shitjeve dhe rrjedhës së parasë dhe të çoj në probleme me hipotezën e vijimësisë.
Shpenzimet e qirasë si kosto fikse, përbëjnë një pjesë domethënëse të shpenzimeve të kompanisë.	Rënia e shitjeve do të thotë se kompania mund ta ketë të vështirë të mbulojë kostot fikse. Është rrezik i madh që kompania mund të dështojë të paguaj borxhet me kohë.
Dy huadhënës janë duke konsideruar të tërheqin kreditë e tyre.	Kompania ka pak gjasa të vazhdojë tregtimin pa kredi. Huadhënësit mund të detyrojnë kompaninë në likuidim.

(c)

Procedurat e auditimit që auditori i kompanisë duhet t'i kryejë për të vlerësuar nëse kompania është e aftë të vijojë sipas hipotezës së vijimësisë janë të listuara më poshtë:

- Përftoni dhe rishikoni parashikimet e rrjedhës së parasë dhe vlerësoni nëse është përfshirë ndikimi i rënies së shitjeve. Vlerësoni supozimet e bëra lidhur me shitjet e parashikuara nga sistemi online.
- Rishikoni pasqyrat menaxheriale pas fundit të vitit për dëshmi në rënie të performancës. Kjo mund të përfshijë ekzaminimin nëse kompania është në gjendje të mbulojë kostot e financimit.
- Rishikoni të dhënat për shitjet pas fundit të vitit lidhur me shitjet e produktit të mësimin online për të përcaktuar nëse besimi i drejtorëve është i arsyeshëm.
- Diskutoni me menaxhmentin nëse kanë identifikuar ndonjë burim alternative të financimit në rast të tërheqjes së kredive nga bankat.
- Diskutoni me drejtorët cilat janë planet e tyre lidhur me zbritjet e çmimeve të ofruara nga konkurrenca.
- Ekzaminoni korrespondencat me avokatët për të vlerësuar nëse dëmshpërblimi do të realizohet dhe për të identifikuar nëse mund të ketë gjoba të mëtutjeshme kundrejt kompanisë.
- Rishikoni procesverbalet e takimit të bordit për të identifikuar cilat janë planet e kompanisë lidhur me publicitetin negativ.
- Rishikoni korrespondencat me bankat për të përcaktuar nëse kompania ka shkelur ndonjë kusht nga bankat dhe që mund të ndikojë në vazhdimin e kredisë ose overdrafteve.
- Diskutoni me drejtorët cilat janë planet e tyre për publicitetin negativ nga shkelja e ligjit për mbrojtjen e të dhënave
- Diskutoni me drejtorët nëse planifikojnë të zëvendësojnë zhvilluesin e produkteve dhe vlerësoni se deri ku kanë shkuar planet për punësimin e personit të ardhshëm.

(d)

Pasiguria lidhur me përtëritjen dhe ristrukturimin e kredisë është një çështje e një rëndësie fundamentale, e cila duhet të sjellet në vëmendjen e aksionarëve.

Do të duhej të përfshihet një paragraf i pasigurisë materiale lidhur me hipotezën e vijimësisë në raportin e auditimit.

Ky paragraf duhet të përfshihet pas paragrafit të opinionit dhe do të shpjegonte pasigurinë lidhur me hipotezën e vijimësisë dhe do t'i referohej një shënimi në pasqyrat financiare ku janë paraqitur informatat e detajuara.

Opinionin e auditimit nuk do të ndryshonte, do të mbetet i pamodifikuar. Nëse megjithatë drejtorët do të dështonin të përfshinin një shënim në pasqyra financiare, auditori do të kualifikonte (rezervonte) opinionin me 'përveç për' për shkak të anomalisë materiale. Pasqyrat financiare do të përmbanin anomali për shkak të mos-shpalosjes së një pasigurie.

Detyra 5

(a) Ju jeni njëri nga partnerët e auditimit në firmën Klopp Kosova, një firmë anëtare e një rrjeti ndërkombëtar të firmave të auditimit. Tash së voni, një anëtare tjetër e rrjetit, Klopp Montenegro, ju ka referuar për një angazhim lidhur me shërbimet që do të ofrohen një kompanie në vendin tuaj që do të blihet nga një kompani multinationale. Departamenti i shërbimeve për financa të korporatave brenda firmës tuaj ka krijuar një ekip që do të merret me vlerësimin e kësaj kompanie. Deri sa jeni Klopp Albania, ju ka kërkuar të kryeni shërbimet e ngjashme për kompaninë e njëjtë. Gjatë konsiderimit të çështjeve etike nga ju, lidhur me këto kërkesa për angazhim, ju ka arritur edhe një kërkesë, tani nga dega në Kosovë e kompanisë multinationale e interesuar për të kryer shërbimet e njëjta të vlerësimit për kompaninë vendore që do të blihet.

Kërkohet:

Diskutoni çështjen që duhet konsideruar dhe veprimet që mund të keni në dispozicion për të adresuar çështjen. (8 pikë)

(b) Soloro ShA prodhon panele solar dhe ka një fabrikë dhe katër depo për ruajtjen e produkteve të gatshme. Fundi i vitit raportues i Panda është 31 dhjetor 2022. Auditimi është gati në përfundim dhe pasqyrat financiare së bashku me raportin e auditimit do të nënshkruhen javën e ardhshme. Të hyrat për vitin janë €55 milion dhe fitimi para tatimit është €5.6 milion.

Kanë ndodhur dy ngjarje pas fundit të vitit. Nuk ka pasur korrigjim ose shpallje në pasqyrat financiare.

Ngjarja 1 - Panelet me defekt

Soloro ndërmerr kontrolle të detajuara të cilësisë para se panelet të dërgohen te konsumatorët. Testimi me 3 janar 2023 ka rezultuar se një sasi e paneleve solare të prodhuara gjatë dhjetorit 2022 ishin me defekt. Kostoja e kësaj sasive ishte €0.85 milion. Në gjendjen e tillë, këto produkte mund të shiten si mbeturina për €0.1 milion. Kosto për ta përmirësuar këtë dëmtim janë shumë domethënëse për menaxhmentin e Soloro, nëse konsiderojnë këtë alternativë.

Ngjarja 2 - Zjarri

Një zjarr ka shpërthyer në depon më të vogël nga katër sa ka kompania me 20 janar 2023. Kjo rezultoi me disa dëmtime në produkte dhe prona, impiante dhe pajisje. Menaxhmenti i Soloro e hetoi shkakun e zjarrit dhe besojnë se nuk do të jenë në gjendje të kërkojnë dëmshpërblim nga kompania e sigurimit. Menaxhmenti i Soloro ka vlerësuar se vlera e mallrave dhe pasurive joqarkulluese të dëmtuara është €0.9 milion dhe tani nuk kanë vlerë si mbeturinë.

Kërkohet:

Për secilin nga elementet më sipër:

(i) Shpjegoni nëse pasqyrat financiare kërkohet të korrighohen; dhe

(ii) Përshkruani procedurat e auditimit që duhet të kryhen për të ardhur në konkludim nëse duhet korrigjuar pasqyrat. 12 pikë

Shënim: totali i pikëve do të ndahet në mes të dy ngjarjeve

(Total: 20 Pikë)

Zgjidhja

a. Kodi i etikës thekson se një nga kërcënimet e pavarësisë mund të krijohet kur profesionistët kryejnë shërbime për klientët tek të cilët interesat mund të jenë në konflikt ose ka mosmarrëveshje në mes tyre lidhur me çështjen për të cilën ofrohet shërbimi.

Varësisht nga rrethanat të cilat shkaktojnë konfliktin e interesit, është e nevojshme zbatimi i masave mbrojtëse:

Njoftimi i të gjitha palëve për të cilat auditori ofron shërbime lidhur me çështjen dhe marrja e pëlqimit nga ato palë;

Përveç kësaj, auditori do të përcaktojë zbatimin e masave shtesë:

- Përdorimi i ekipeve të veçanta të angazhimit;
- Procedura të parandalimit në qasje të informatave nga ekipet e ndryshme;
- Udhëzues të qartë për anëtarët e ekipeve të angazhimit lidhur me çështjen e sigurisë dhe konfidencialitetit;
- Përdorimi i marrëveshjeve për konfidencialitet të nënshkruara nga punonjësit dhe partnerët e firmës; dhe
- Rishikimi i rregullt i zbatimit të masave mbrojtëse nga individët senior që nuk janë të përfshirë në angazhimet relevante me klientët.

Kur konflikti i interesit krijon kërcënim për një ose më shumë parime fundamentale të, përfshirë, objektivitetin, konfidencialitetin, sjelljen profesionale, që nuk mund të elimionohet ose zvogëlohet me masa mbrojtëse në nivel të pranueshëm, auditori duhet të mos pranojë angazhimin ose duhet të heqë dorë nga njëri angazhim.

Dy angazhimet e para mund të mos jenë në kundërshtim me Kodin e Etikës nëse aplikohen masa të duhura mbrojtëse; angazhimi i tretë mund të jetë i mundshëm nëse zbatohen masat mbrojtëse; mirëpo çështja është nëse firma ka burime të mjaftueshme për të demonstruar nëse është në pajtueshmëri me kodin e etikës.

(b)

Ngjarjet pas datës së raportimit

Ngjarja 1 – Panelet me defekt

Procedurat e kontrollit të cilësisë së Soloro kanë identifikuar se stoqet në vlerë prej €0.85 milion janë me defekt; vlera si mbeturinë e tyre është €0.1 milion. Kjo informatë është marr pas fundit të vitit por ofron dëshmi për vlerën neto të realizueshme para fundit të vitit, prandaj është ngjarje që kërkon korrigjim ne PF.

SNK 2 Stoqe, kërkon që stoqet të vlerësohen me vlerën më të ulët në mes të kostos dhe vlerës neto të realizueshme. Stoqet në vlerë prej €0.85 milion duhet të sjellen në vlerën neto të realizueshme prej €0.1 milion. Shuma e shlyer prej €0.75 milion është materiale për PF sepse përfaqëson 13.4% (0.75/5.6) të fitimit para tatimit dhe 1.4% (0.75/55) të të hyrave. Prandaj drejtorët duhet të korrigjojnë PF duke sjellur stoqet në vlerë prej €0.1 milion.

Procedurat e auditimit në vijim duhet të kryhen për të arritur në konkluzionin për korrigjim:

– Rishikimi i procesverbalëve të takimeve të bordit dhe raporteve të kontrollit të cilësisë për të vlerësuar nëse ngjarja ka qenë e vetmja dhe nuk ka stoqe tjera që janë me defekte.

- Diskutimi i çështjet me drejtorët, vlerësimi nëse kompania ka stoqe të mjaftueshme për të vazhduar aktivitetet.
- Përftimi i përfaqësimeve të shkruara për të konfirmuar se kompania është duke operuar sipas hipotezës së vijimësës.
- Merrni një listë të stoqeve të dëmtuara dhe harmonizoni me dokumentet mbështetëse të prodhimit.
- Diskutoni me menaxhmentin se si kanë vlerësuar se vlera e stoqevet të dëmtuara është €0.1 milion dhe harmonizoni këtë shumë me dokumentet mbështetëse.

Ngjarja 2 - Zjarri

Ka ndodhur një zjarr dhe janë dëmtuar pasuri në vlerë prej €0.9 milion të cilat nuk kanë vlerë të mbetur. Drejtorët nuk besojnë se mund të kërkojnë dëmshpërblim nga kompania e sigurimeve. Kjo ngjarje ka ndodhur pas fundit të vitit dhe dëshmitë nuk kanë ekzistuar para fundit të vitit, prandaj është ngjarje që nuk kërkon korrigjim në PF.

Pasuritë e dëmtuara në vlerë prej €0.9 milion janë materiale sepse përfaqësojnë 16.1% të fitimit para tatimit dhe 1.6% të të hyrave. Si ngjarje materiale që nuk kërkon korrigjim, pasuritë nuk duhet të shlyehet; mirëpo drejtorët duhet të konsiderojnë shpalosjen e ngjarjes dhe vlerën e pasurive të ndikura nga ngjarja.

Procedurat e auditimit në vijim duhet të kryhen për të arritur në konkluzionin për korrigjim:

- Përftimi i një liste të pasurisë së dëmtuar dhe harmonizimi me vlerën neto në libra nga regjistri i pasurive joqarkulluese për të konfirmuar vlerën e dëmtuar.
- Merrni një listë të stoqeve për të vërtetuar nivelin e stoqeve në kohën e eksplodimit.
- Diskutoni me drejtorët nëse ata do të shpalosin efektin e eksplodimit në PF.
- Diskutoni me drejtorët pse nuk janë në gjendje të marrin dëmshpërblimin nga kompania e sigurimeve;